Funded by the European Union

BE-ja për zhvillim ekonomik: zhvillim ekonomik lokal i nxitur nga turizmi, me fokus në trashëgiminë kulturore (EU4EconomicDevelopment)



Duration: 01.02.2021 - 31.01.2028

Countries:
Albania

EU contribution: € 6 000 000

Total budget: € 6 250 000

Implementer:
Agenzia Italiana per la Cooperazione allo Sviluppo (AICS)

Social media:
facebook.com/share/1CJHQySp3Z/?mibextid=wwXIfr, instagram.com/parkuarkeologjikbylisklos/?hl=en

Website(s): www.bylisklos.al

Project description:

Projekti mbështet zhvillimin ekonomik vendor të qëndrueshëm në Shqipëri përmes mbrojtjes, menaxhimit dhe vlerësimit të Parkut Arkeologjik të Bylisit–Klosit, një prej siteve më të rëndësishme të trashëgimisë kulturore në vend. I financuar nga Bashkimi Evropian dhe i zbatuar nga AICS, në partneritet me Ministrinë e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, si edhe me institucionet kombëtare të trashëgimisë kulturore, projekti ndërthur ruajtjen e trashëgimisë kulturore me zhvillimin e turizmit dhe fuqizimin e komunitetit.
Projekti financon punime për ruajtjen dhe mbrojten, infrastrukturën për vizitorët, programet për ngritjen e kapaciteteve, grante për zhvillimin lokal dhe mbështetje institucionale për qeverisjen e parkut. Përmes një qasjeje të integruar, projekti synon:
- të përmirësojë cilësinë e shërbimeve turistike, të forcojë sipërmarrjen vendore, të krijojë mundësi punësimi dhe të rrisë pjesëmarrjen e komuniteteve lokale në përdorimin e qëndrueshëm të trashëgimisë kulturore.
Duke lidhur ruajtjen e trashëgimisë me zhvillimin ekonomik, projekti kontribuon në rritje gjithëpërfshirëse dhe në rritjen e atraktivitetit të rajonit të Mallakastrës si destinacion i turizmit kulturor.

Expected results:

•forcimi dhe bërja funksionale e kuadrit të ruajtjes dhe menaxhimit të Parkut Arkeologjik të Bylis–Klosit;
•realizimi i investimeve strategjike në ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe infrastrukturës për vizitorët;
•mbështetja e bizneseve lokale dhe nismave komunitare përmes granteve dhe asistencës teknike;
•rritja e kapaciteteve të profesionistëve të trashëgimisë, guidave, institucioneve publike dhe palëve të interesuara vendore përmes programeve të specializuara të trajnimit;
•rritje e interesit turistik dhe mundësive socio-ekonomike përmes vlerësimit të qëndrueshëm të trashëgimisë kulturore.